



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE



Klima e Biznesit në Kosovë

TM4 - 2022

Shkurt 2023

INDIKATOR MATËS I TENDENCËS NË BIZNES

Tremujori i katërt i vitit 2022



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE



Të nderuar miq dhe kolegë

Iniciativa për rifillimin e publikimit të raportit “Monitorimi i bizneseve në Kosovë” nga Oda Ekonomike e Kosovës, është një hap i rëndësishëm që siguron informacione të sakta për bizneset në Kosovë. Oda Ekonomike e Kosovës gjatë këtij studimi synon që përveç informimit të përceptimit të komunitetit të biznesit të trendëve

të bizneseve të Kosovës, gjithashtu të promovoj vlerat e biznesit të Kosovës dhe të kontribuoj në përafrimin e tyre me vlerat Evropiane.

Oda Ekonomike e Kosovës gjatë aktivitetit të saj ka pasur për qëllim të rrisë nivelin gjeneral të ndërgjegjësimit të shoqërisë në lidhje në vlerën e sipërmarrësisë që Kosova posedon. Në lidhje me këtë, rol të rëndësishëm në krijimin e vlerave të brendshme në Kosovë dhe vendosjen e tyre në tregjet nacionale dhe internacionale e ka komuniteti i biznesit i cili ndikon në ngritjen e mirëqenies së ekonomisë dhe shoqërisë në tërësi. Prandaj, për ngritjen e imazhit të shtetit tonë dhe për tërheqjen e investitorëve të huaj kah format e ndryshme të partneritetit.

Ky publikim para se gjithash do t’u shpërndahet të gjitha kompanive që kanë participuar në studim, të gjitha institucionet shtetërore, organizatat e biznesit, zyrat diplomatike, organizatat e donatorëve dhe të gjitha grupet e interesit të cilat në mënyrë direkte dhe indirekte influencohen nga promovimi i aktiviteteve të ekonomisë së Kosovës. Gjithashtu, ky studim do t’u shpërndahet atyre që kanë ndihmuar në ngritjen e imazhit të Kosovës dhe vlerave të tyre në Kosovë dhe jashtë vendit.

Që nga 2023 ky studim do të ketë vend të rregullt në baza tre mujore.

Me respekt

Lulzim Rafuna

Kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës

Përmbledhje

Oda Ekonomike e Kosovës ka implementuar studimin e klimës së biznesit në Kosovë. Informacionet që rrjedhin nga anketat iu lehtësojnë marrjen e vendimeve për njerëzit që udhëheqin biznes dhe politikë bërësit. Gjithashtu edhe investitorët direkt dhe të huaj kërkojnë këto informacione. Monitorimi i analizës së bizneseve konsiderohet një burim informacioni me shumë rëndësi në aktivitetin ekonomik të një shteti.

Ato përdoren nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së sikurse edhe në të gjitha ekonomitë e zhvilluara në të gjithë botën.

Anketat fokusohen në 5 sektorë: prodhim, ndërtim, shërbim, tregti me pakicë dhe tregti me shumicë.

Monitorimi i analizës së bizneseve mbledh informacionet nga menaxheret e bizneseve gjatë vlerësimit të tyre për situatën ekonomike dhe në lidhje me synimet dhe pritshmëritë për të ardhmen e afërt. Informacionet kualitative mund të sigurohen shpejt, lehtë, dhe janë shpesh më të besueshme se figurat sasiore.

Rezultatet sigurojnë depërtimin në tendenca, e jo në sasi. Ato plotësojnë statistikatat zyrtare sasiore të cilat dorëzohen më vonë.

Situata e përgjithshme e biznesit sipas kësaj analize konsiderohet të jetë e favorshme për bizneset kosovare. Gjetjet nga ky tremujor tregojnë se 32.30% e kompanive vlerësojnë situatën e tyre të biznesit si të mirë ,42.20% e tyre si të kënaqshme dhe normale për këtë periudhë të vitit.

Sa i përket pritjeve për punësim në tre muajt e ardhshëm janë nga rreth 43.10% e bizneseve pjesëmarrëse në këtë studim pretendojnë të rrisin numrin e punëtorëve dhe rreth 50% e tyre pretendojnë se do mbetet i pandyshuar numri i të punësuarve, ky parashikim i bizneseve pritet të ndikojë edhe në zbutjen e papunësisë në nivel të vendit.

Në periudhën gjashtëmujore, bizneset presin që aktiviteti i tyre biznesor të ketë një zhvillim më të madh. Rreth 51% e bizneseve të intervistuar presin që aktiviteti i biznesit të përmirësohet, ndërsa 36.30% e tyre presin që gjendja të mbetet e njëjtë dhe vetëm 12.70% e bizneseve të anketuara konsiderojnë se situata biznesore e tyre do të zhvillohet në mënyrë të pafavorshme.

Përmbajtja

Përmbledhje	4
1. Hyrja dhe metodologjia	6
2. Treguesi i klimës së biznesit	9
2.1 Vlerësimi i situatës aktuale nga bizneset	10
2.2. Pritjet për tre muajt e ardhshëm për rritjen e numrit-të të punësuarve	10
2.3. Pritjet mbi çmimet e produkteve/shërbimeve të bizneseve në tre muajt e ardhshëm.....	11
2.4. Pritjet e biznesve për gjashtë muajt e ardhshëm	12
2.5. Gjendja momentale e shfrytëzimit të kapaciteteve nga bizneset.....	13
3. Analiza Sektoriale	13
3.1. Prodhimi.....	13
3.2. Sektori i ndërtimit	15
3.3. Tregtia me pakicë.....	16
3.4. Tregti me shumicë.....	17
3.5 Shërbimet	18
4. Barrierat për zhvillim sektorial	20
5. Deklarata e Përgjithshme dhe konkluzione.....	21

1. Hyrja dhe metodologjia

Oda Ekonomike e Kosovës e kryen monitorimin e analizës së bizneseve për të vlerësuar perceptimin e njësive të biznesit në lidhje me mjedisin apo klimën mbizotëruese në vend. Informacioni që rrjedh nga studimi mund të ndihmoj për të përmirësuar vendimmarrjen për njerëzit e biznesit dhe politikë bërësit. Gjithashtu investitorët direkt dhe të huaj kërkojnë informacione të tilla. Monitorimi i analizës së bizneseve është konsideruar një burim shumë i rëndësishëm informacioni për aktivitetet ekonomike të një vendi. Ato janë aplikuar në të gjitha vendet anëtare të BE-së, si dhe në të gjitha vendet ekonomikisht më të zhvilluara në të gjithë botën.

Anketat kryhen në baza tre mujore dhe sigurojnë detaje në atë se si e përceptojnë kompanitë situatën aktuale të biznesit dhe si i vlerësojnë pikëpamjet e bizneseve të tyre. Në këtë mënyrë, Oda Ekonomike e Kosovës mundëson të parashikoj pritjet ekonomike. Monitorimi i analizës së bizneseve është i dizajnuar dhe udhëhiqet nën përgjegjësinë e Odës Ekonomike të Kosovës.

Në këtë cikël të anketimit rreth 102 kompani janë intervistuar. Këto kompani janë selektuar nga listat e siguruara nga autoritetet zyrtare të Kosovës. Participimi në anketa ka qenë vullnetar, përderisa kualiteti i rezultateve varet nga gatishmëria e ndërmarrësve për pjesëmarrje. Intervistat janë realizuar ballë për ballë dhe me pyetësorë online. Intervistat janë kryer në muajin Janar dhe në fillim të muajit Shkurt 2023. Të dhënat nga këto anketa përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe nuk shfrytëzohen për qëllime tjera. Të dhënat individuale të marrura nga bizneset pjesëmarrëse në këtë studim, nuk mund të përdoren për publikime tjera. Të dhënat e mbledhura janë përpunuar dhe analizuar nga Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Politika, brenda OEK-ut.

Sondazhi i Monitorimit të Biznesit mbledh informacione nga menaxheret e bizneseve në vlerësimin e tyre për situatën ekonomike, për qëllimet dhe pritshmëritë për të ardhmen e afërt. Informatat kualitative mund të sigurohen shpejtë, lehtë dhe shpesh janë më të besueshme se paraqitja sasiore. Anketa është e dizajnuar që të mbledh pikëpamjet e menaxherëve të lartë në lidhje me çështjet si: situata e biznesit, volumi i prodhimit, porositë, çmimi dhe punësimi, për të vlerësuar natyrën e biznesit në shtet.

Pyetjet me opsione të shumëfishta për vlerësimin mbi zhvillimet në tre muajt e fundit, vlerësimin e situatës aktuale dhe pritjet për tre deri në gjashtë muajt e ardhshëm. Përgjigjet janë formuluar si në vijim: “rritje, ka mbetur e pandryshuar, rënie” ose “përmirësuar, e pandryshuar,

përkeqësuar”. Duke përdorur një shkallë me tre pikë për opsionet e përgjigjeve, anketa ofron ndryshim të vogël të të dhënave. Kjo lejon që të fitohen rezultate të përfaqësuara statistikisht edhe duke tërhequr një numër më të vogël të kompanive se sa do të ishte rasti në pyetjet sasiore të anketës. Për të rritur më tej përfaqësimin mostra është stratifikuar sipas sektorëve kryesore që kontribuojnë Prodhim (përpunimin e ushqimit, përpunimin e drurit, përpunimin e metaleve, të prodhimit, materialeve ndërtimore), Ndërtim, Tregti, me shumicë dhe pakicë, Shërbimet e selektuara (transporti, shërbimet profesionale, hotelet dhe restorantet) dhe madhësia e kompanisë (e vogël, e mesme, e madhe). Një pjesë më e madhe e mostrës lidhet me kompanitë e vogla, ndërsa një pjesë më e vogël lidhet me kompanitë e mëdha dhe të mesme. Arsyeja për këtë qëndron në atë se 98.2% e kompanive në Kosovë janë kompani të vogla, ndërsa 1.8% të mesme dhe të mëdha.

Tabela 1 tregon pyetësorët e kompletuara në bazë të sektorëve dhe mostrës. Siç mund të shihet nga tabela madhësia e klasave nuk është në vijë me klasifikimet standarde, por këto klasifikime janë bërë duke marrë parasysh kontekstin e Kosovës p.sh. Një kompani e madhe është konsideruar me 50 ose më shumë punëtorë, dhe ky klasifikim aplikohet nga Administrata Tatimore e Kosovës. Tabela 2 Tregon një përmbledhje e pyetësorëve duke u bazuar në rajone dhe në madhësi të kompanive. Ndërsa, Tabela 3 tregon një përmbledhje e pyetësorëve duke u bazuar në rajone dhe në sektorë të kompanive.

Tabela 1: Një përmbledhje e pyetësorëve duke u bazuar në sektor dhe në madhësi të kompanive

Sektorët	Pyetësorët	%	Të vogla (0 – 9)	Të mesme (10 – 49)	Të Mëdha (> 50)
Prodhim	28	27.50	6	14	8
Shërbimet	19	18.60	14	4	1
Ndërtim	10	9.60	4	2	4
Tregti me pakicë	26	25.50	16	6	4
Tregti me shumicë	19	18.60	6	8	5
Gjithsej	102	100	46	34	22
Përqindja nga madhësia			45.10%	33.30%	21.60%

Tabela 2: Një përmbledhje e pyetësorëve duke u bazuar në rajone dhe në madhësi të kompanive

Rajonet	Pyetësorët	%	Të vogla (0 – 9)	Të mesme (10 – 49)	Të Mëdha (> 50)
Prishtinë	40	39.20	19	13	8
Mitrovicë	5	4.90	3	2	0
Pejë	10	9.80	7	0	3
Prizren	12	11.80	2	6	4
Ferizaj	9	8.80	1	3	5
Gjilan	9	8.80	5	3	1
Gjakovë	17	16.70	9	7	1
Gjithsej	102	100	46	34	22
Përqindja nga madhësia			45.10%	33.30%	21.60%


Tabela 3: Një përmbledhje e pyetësorëve duke u bazuar në rajone dhe në sektorë të kompanive

Rajonet	Pyetësorët	%	Prodhim	Shërbimet	Ndërtim	Tregti me pakicë	Tregti me shumicë
Prishtinë	40	39.20	9	9	4	12	6
Mitrovicë	5	4.90	2	0	0	2	1
Pejë	10	9.80	3	5	0	0	2
Prizren	12	11.80	5	2	1	0	4
Ferizaj	9	8.80	4	0	1	3	1
Gjilan	9	8.80	3	1	3	2	0
Gjakovë	17	16.70	2	2	1	7	5
Gjithsej	102	100	28	19	10	26	19
Përqindja nga madhësia			27.50%	18.60%	9.80%	25.50%	18.60%

2. Treguesi i klimës së biznesit

Treguesi i klimës është një matës për aktivitetin ekonomik në vend. Është mesatarja aritmetike ndërmjet situatës dhe treguesit të pritjeve. Treguesi i klimës është mesatarja e balancës së vlerësimit të situatës aktuale dhe pritjeve për tre apo gjashtë muajt e ardhshëm. Ai rregullon pritjet me vlerësimin aktual të situatës. Për shembull, kur pritjet janë se situata do të mbetet e njëjtë dhe vlerësimi i situatës aktuale është i keq në këtë rast mesatarja tregon se klima do të jetë negative. Për shembull, kur pritjet janë se situata do të mbetet e njëjtë dhe vlerësimi i situatës aktuale është i mirë atëherë mesatarja tregon se klima do të jetë pozitive. Kjo përshtat pritjet nga një pozicion i mirë fillestar. Treguesi i klimës së biznesit manifestohet me një përmirësim në këtë tremujor. Duket se ambienti i biznesit në Kosovë ka filluar të prodhojë kushte të favorshme dhe të qëndrueshme për ndërmarrjet e Kosovës. Treguesi i klimës së biznesit manifestohet me një përmirësim të lehtë në këtë tremujor. Kjo dëshmonë se ambienti i biznesit në Kosovë ka filluar të ketë rimëkëmbje të favorshme dhe të lehtë.


Figura 1: Klima e bizneseve në Kosovë (% e kompanive)



2.1 Vlerësimi i situatës aktuale nga bizneset

Gjendja e biznesit në TM4 2022 është e kënaqshme, përkatësisht rreth 74.6% e bizneseve kanë vlerësuar se kanë një gjendje të kënaqshme dhe të mirë për sezonën e vitit biznesor. Megjithatë, në krahasim me tremujorin paraprak gjendja e biznesit ka shënuar një përmirësim të lehtë, pasi që përqindja e bizneseve që vlerësojnë situatën aktuale si të pakënaqshme është më e vogël.


Figura 2: Vlerësimi i situatës aktuale nga bizneset



2.2. Pritjet për tre muajt e ardhshëm për rritjen e numrit të punësuarve

Sipas anketimit rreth 43.10% e kompanive kanë pritje pozitive për rritjen e numrit të punësuarve. Megjithatë, rreth 50% e kompanive të intervistuar presin që ta mbajnë numrin e njëjtë të punëtorëve në tre muajt e ardhshëm. Ku nga ky total 6.9% e bizneseve presin të zvogëlojnë numrin e të punësuarve kryesisht kanë arsyetuar që kanë probleme financiare dhe parashikojnë se do ketë krizë të mungesës së puntorëve pasi që ata po lëshojnë vendin e punës për të emigruar.


Figura 3: Pritjet mbi numrin e të punësuarve nga bizneset në 3 muajt e ardhshëm



2.3. Pritjet mbi çmimet e produkteve/shërbimeve të bizneseve në tre muajt e ardhshëm

Kosova përjetoi një përmirësim ekonomik pas pandemisë, megjithatë për shkak të çrregullimeve në ekonominë globale, Kosova u ballafaqua me pasiguri dhe çmime të larta në vitin 2022. Inflacioni i çmimeve të konsumit u rrit ndjeshëm në vitin 2022, duke arritur një mesatare prej 11.6%. Inflacioni ka pasur trend rritëse duke filluar nga 7.1% në janar, duke arritur kulmin në korrik me 14.2% që është niveli më i lartë në periudhën për të cilën të dhëna për inflacionin janë në dispozicion. Kjo rritje është reflektim i rritjes së çmimeve të ‘ushqimeve’, ‘transportit’, ‘metaleve bazë’, ‘energjisë’, zhvillimet e të cilave përcaktohen shumë nga luhajatet globale të çmimeve të ushqimeve, energjisë dhe naftës. Në figurën 4 kemi rreth 40.6% të kompanive që kanë deklaruar se do të ketë rritje të çmimeve, 42.6% do të mbesin çmimet e njëjta nëse nuk do të kenë ngritje të çmimeve në treg dhe kemi një përqindje të ulët rreth 16.8% që mendojnë se do të ketë ulje të çmimeve.


Figura 4: Pritjet mbi çmimet e produkteve/shërbimeve të bizneseve në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)



2.4. Pritjet e bizneseve për gjashtë muajt e ardhshëm

Pritshmëritë e bizneseve për gjashtë muajt e ardhshëm janë 51% të kenë përmirësim dhe rreth 36.3% të mbeten përafërsisht në gjendje të njëjtë dhe 12.7% kanë tendencë për zhvillim në mënyrë të pafavorshme bazuar në rezultatet nga figura 5.


Figura 5: Pritjet e bizneseve për 6 muajt e ardhshëm(% e kompanive)



2.5. Gjendja momentale e shfrytëzimit të kapaciteteve nga bizneset

Nga studimi mund të nxjerrim rezultate se rreth 48% e kompanive potencuan se shfrytëzojnë nën 51% të kapaciteteve të tyre, gjë që është një rezultat jo i kënaqshëm pasi që ato nuk shfrytëzojnë gjysmën e kapaciteteve të tyre sipas potencialit që kanë. Përqindje më të lartë të shfrytëzimitë ndajnë kompanitë, respektivisht 37% të cilat deklaruan se shfrytëzojnë 51-60% dhe 12% e tyre shfrytëzojnë 61-70% të kapaciteteve. Kompanitë participuese në këtë studim deklaruan se 1% dhe 2% e tyre shfrytëzojnë 71%, respektivisht 90% të kapaciteteve të tyre. Me këto deklarata vërejm se kompanitë kanë mundësi të shfrytëzimit edhe me të madh të kapaciteteve por kemi probleme të ndryshme si p.sh. çmimi i lëndës së parë, mungesa e kërkesës së tregut, mungesa e investimeve kapitale në vend, mungesa e cash-it etj.

Figura 6: Gjendja momentale e shfrytëzimit te kapaciteteve nga bizneset (% e kompanive)




3. Analiza Sektoriale

3.1. Prodhimi

Sektori i prodhimit në Kosovë vazhdon të ketë një nivel të ulët të aftësisë konkurruese e kjo kryesisht për shkak të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Pjesëmarrja e sektorit të


prodhimit në GDP-i është e krahasueshme me disa vende të rajonit, por duke marrë parasysh nevojat e zhvillimit, duke përfshirë nevojën për të krijuar vende pune, është e ulët. Gjetjet e paraqitura në Figurën 7 tregojnë se aktiviteti prodhues gjatë tre muajve të fundit është rritur tek rreth 44.44% të kompanive të anketuara, ndërsa në 18.53% të rasteve ka rënë dhe ka mbetur i pandryshuar në 33.33% të kompanive prodhuese. Vetëm 3.70% e kompanive pjesëmarrëse në këtë hulumtim deklaruan se nuk prodhojnë produktet e tyre për Kosovë, por për vendet e tjera.

Figura 7: Prodhimi në 3 muajt e fundit (% e kompanive)



Në sektorin e prodhimit në tremujorin e ardhshëm 70.37% e bizneseve presin që të rrisin kapacitetet e tyre prodhuese, 18.5% e tyre do të mbetet e pandryshuar dhe vetëm 7.41 % deklaruan që aktivitetit i tyre prodhues parashikohet të ketë rënie, ndërsa 3.70% kanë deklaruar se nuk prodhojnë për Kosovë. Kështu, perspektiva e përgjithshme e biznesit për tre muajt e ardhshëm duket të jetë optimiste.


Figura 8: Pritjet për prodhim në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)



3.2. Sektori i ndërtimit


Rezultatet e paraqitura në figurën 9 tregojnë se kompanitë në sektorin e ndërtimit konsiderojnë se zhvillimi i aktivitetit të biznesit të tyre në 3 muajt e fundit është rritur për 50%, 40% e kompanive të ndërtimit treguan se situata e biznesit ka mbetur e pandryshuar dhe rreth 10 % e bizneseve pjesëmarrëse në këtë studim kanë deklaruar se aktiviteti i tyre biznesor është përkeqësuar apo ka rënë. Rezultatet pozitive ishin për shkak të kushteve atmosferike të mira gjatë fundit të vitit 2022.

Figura 9. Zhvillimi i biznesit në tre muajt e fundit (% e kompanive)



Në sektorin e ndërtimit në tremujorin e ardhshëm 60% e bizneseve presin që të kenë situatë të përmirësuar, 40% e tyre presin që të mbetet përafërsisht e njëjtë dhe vlen të theksohet se bizneset e anketuara kanë deklaruar që nuk do të hasin në zhvillim të pafavorshëm. Kështu, perspektiva e përgjithshme e bizneseve për tre muajt e ardhshëm është optimiste.


Figura 10: Pritjet për ndërtim në gjashtë muajt e ardhshëm (% e kompanive)



3.3. Tregtia me pakicë


Rreth 34.62 % e kompanive të sektorit të tregtisë me pakicë kanë deklaruar se aktiviteti i tyre biznesor në tre muajt e fundit ka mbetur i pandryshuar. Përmirësim në aktivitetin e tyre kishin 19.23% e kompanive të këtij sektori dhe 46.15% e kompanive deklaruan se patën gjendje të përkeqësuar në krahasim me vitet e kaluara kjo për arsye të ngritjes së çmimeve.

Figura 11: Zhvillimi i biznesit në tre muajt e fundit (% e kompanive)



Sektori i tregtisë me pakicë është optimist rreth pritjeve në lidhje me performancën biznesore. Rreth 46.15% e kompanive presin që aktiviteti i tyre i biznesit të ketë rritje në tre muajt e ardhshëm, 34.62% presin që të mbetet i pandryshuar dhe vetëm 19.23% presin të përkeqësohen në krahasim me 46.15% të atyre biznese që momentalisht kanë gjendje të përkeqësuar.


Figura 12: Pritjet në lidhje me aktivitetin e biznesit në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)



3.4. Tregti me shumicë


Rreth 31.58% e tregtarëve me shumicë konsiderojnë se zhvillimi i biznesit të tyre gjatë tre muajve të fundit është përmirësuar. Bazuar në përgjigjet e kompanive të anketuara të këtij sektori rreth 42.11% e tyre potencuan se nuk kishin ndryshim në gjendjen e tyre. Aktiviteti biznesor ishte zvogëluar gjatë 3 muajve të fundit tek 26.32% e kompanive ku në këtë rënie shkaktar kryesor e shohin rritjen e çmimeve.

Figura 13: Zhvillim i biznesit në tre muajt e fundit (% e kompanive)



Që aktiviteti biznesor të përmirësohet presin rreth 52.63% e kompanive që operojnë në këtë sektor, ndërsa 36.84% nuk parashikojnë ndonjë ndryshim në gjendjen e tyre. Vetëm 10.53% e respondentëve presin një përqësimit në aktivitetin e tyre përkatës në krahasim me 26.32% sa janë tani.


Figura 14: Pritjet e aktivitetit biznesor në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)



3.5 Shërbimet


Në dy vitet e fundit, zhvillimi i sektorit të shërbimeve kishte një rënie në ekonominë e vendit, kryesisht kjo ka ndodhur nga koha e pandemisë Covid-19-të. Nga evidenca e marrë nga kompanitë që operojnë në këtë sektor 36.84% e kompanive deklaruan se gjendja e biznesit në tre muajt e fundit është përmirësuar dhe 26.32% e tyre ka mbetur e pandryshuar; rreth 36.84% e kompanive nuk ishin të kënaqura me aktivitetin e tyre biznesor në tre muajt e fundit.

Figura 15: Situata e biznesit në tre muajt e fundit(% e kompanive)



Sa i përket pritjeve për tre muajt e ardhshëm, 36.84% e kompanive deklaruan se qarkullimi në tre muajt e ardhshëm do të mbetet i pandryshuar, një zhvillim të favorshëm apo rritje të qarkullimi presin të kenë rreth 57.89% e bizneseve të anketuara dhe vetëm 5.26 % presin një gjendje të ulët apo presin një përkeqësim të aktivitetit biznesor. Kështu, perspektiva e përgjithshme e këtij sektori për tre muajt e ardhshëm duket të jetë optimiste.

Figura 16: Pritjet e aktivitetit biznesor në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)



4. Barrierat për zhvillim sektorial

Tabela 4: Barrierat e të bërit biznes sipas të gjithë sektorëve

Barrierat	Sektori i tregtisë me shumicë	Sektori i tregtisë me pakicë	Sektori i shërbimeve	Sektori i prodhimit	Sektori i ndërtimit
Mungesa e porosive	5.30%	0%	5.60%	17.90%	20%
Mungesa e personelit të kualifikuar	11%	30.77%	33.33%	50%	30%
Kapacitetet teknike të vogla	5%	3.85%	11.11%	14.29%	0%
Mungesa e mjeteve financiare	37%	26.92%	22.22%	28.57%	40%
Vështirësi në marrjen e kredive	5%	7.69%	16.67%	10.71%	10%
Kamata e lartë	37%	23.08%	33.33%	39.29%	40%
Mungesa e hapësirës dhe mjeteve	0%	7.69%	5.56%	17.86%	0%
Konsumatorwt nuk paguajnë në kohë	37%	15.38%	22.22%	39.29%	40%
Ekonomia informale	53%	50.00%	22.22%	32.14%	10%
Konkurrenca jo lojale	63%	65.38%	61.11%	60.71%	40%

5. Deklarata e Përgjithshme dhe konkluzione

Për këtë studim të monitorimit të bizneseve është mbledhur informacion nga menaxheret e bizneseve për vlerësimin e situatës ekonomike, për synimet dhe pritjet e tyre për TM4 të vitit 2022 dhe të ardhmen e afërt.

Rreth 102 kompani janë intervistuar në sektorin e prodhimit, ndërtimit, shërbimeve dhe tregtisë me pakicë dhe tregtisë me shumicë. Gjetjet kryesore të nxjerra nga ky studim janë të kualifikuara nga kompanitë në mbulimin e sektorëve, gjendja e përgjithshme e biznesit konsiderohet të jetë deri në një masë e favorshme për bizneset kosovare. Kompanitë në sektorin të Sërbimit, Tregtisë me pakicë dhe Tregtisë me shumicë janë më pak të kënaqura me gjendjen aktuale të biznesit, ndërsa sektori i ndërtimit pasuar nga ai i prodhimit janë sektorët ku kompanitë janë më të kënaqura, kjo kënaqshmeri e tyre pasqyrohet për shkak të kushteve të mira klimatike gjatë kësaj periudhe të vitit.

E këto rezultate po ashtu tregojnë një situatë të mirë, sepse si prodhimi ashtu edhe sektori i ndërtimit janë sektorët që ndikojnë më së shumti në rritjen ekonomike. Përveç analizave të përgjithshme dhe të detajuara sipas sektorëve, ky studim gjithashtu ka vlerësuar edhe barrierat e bizneseve.

Nga të dhënat e mbledhura është konstatuar se mungesa e mjeteve financiare(cash) është pengesa kryesore që përballen bizneset dhe kjo është më e theksuar në sektorin e shitjes me shumicë, pakicë dhe në sektorin e prodhimit. Normat e larta të interesit, vonesat në pagesa nga konsumatorët, mungesa e stafit të kualifikuar, janë cilësuar si pengesa apo barriera tjera të rëndësishme më të cilat përballen bizneset kosovare. Ndër barrierat tjera bizneset e kanë cilësuar ekonominë informale, koston e lartë të energjisë elektrike, mungesën e profesionalizmit në institucione publike, procedurat doganore dhe fuqinë blerëse të vogël si pengesa tjera që ndikojnë në aktivitetin e tyre.

Si konkluzion, partneriteti i shtuar mes komunitetit të biznesit dhe qeverisë, respektivisht mes Odës Ekonomike të Kosovës dhe Ministrisë së Financave dhe orientimi i kësaj të fundit në favor të bizneseve ka krijuar një ambient më të mirë dhe më të favorshëm të të bërit biznes në vend.



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara ©2023
Oda Ekonomike e Kosovës



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Rr. Nëna Terezë, Nr.20
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org